

Statistikat e transportit

Nëntor 2017

Tiranë, më 27 Dhjetor 2017: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Nëntor 2017 është 342 mijë ton.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2017, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 3,7 mln ton, duke u rritur me 8,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Porti i Durrësit zë 93,5 %, të gjithë mallrave të ngarkuara/shkarkuara në të gjitha portet gjatë periudhës Janar – Nëntor 2017.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 3,5 mln ton - kilometër, duke u rritur me rreth 4 herë krahasuar me Nëntor 2016.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2017, ky volum është 24 mln ton- kilometër, duke u rritur me rreth 3 herë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

ton

Periudha	Det	Hekurudhë	Ajër*
Nëntor -2016	341.972	6.560	178
Nëntor -2017	341.804	21.247	190
Ndryshimi vjetor (%)	-0,05	223,9	6,7
Janar - Nëntor 2016	3.429.475	67.180	1.978
Janar - Nëntor 2017	3.713.446	141.850	2.048
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	8,3	111,1	3,5

* Përfshin mallrat dhe postën

Në muajin Nëntor 2017, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 190 ton, duke u rritur 6,7 %, krahasuar me Nëntor 2016.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2017, me ajër janë transportuar 2.048 ton mallra, duke u rritur 3,5 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e 2016.

Numri i fluturimeve të kryera, në Nëntor 2017, është 1.872, duke shënuar një rritje me 4,5 %, ndaj Nëntor 2016.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2017, janë kryer 22.180 fluturime, duke u rritur me 9,8 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Nëntor - 2016	15	1.792	7.922
Nëntor - 2017	19	1.872	9.081
Ndryshimi vjetor (%)	26,7	4,5	14,6
Janar - Nëntor 2016	15	20.204	153.362
Janar - Nëntor 2017	19	22.180	156.330
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	26,7	9,8	1,9

Në muajin Nëntor, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 186.164, duke u rritur 5,9 %, krahasuar me Nëntor 2016.

Në njëmbëdhjetëmujori e 2017, transporti ajror i pasagjerëve zë 61,7 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në njëmbëdhjetëmujorin e 2017 është 2.410.997 duke u rritur me 21,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Nëntor - 2016	-	47.435	175.763
Nëntor - 2017	1.963	51.749	186.164
Ndryshimi vjetor (%)	-	9,1	5,9
Janar - Nëntor 2016	88.560	1.205.013	1.988.735
Janar - Nëntor 2017	63.874	1.431.999	2.410.997
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-27,9	18,8	21,2

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Nëntor 2017 është 51.749 persona, krahasuar me Nëntor 2016, ky tregues është rritur 9,1 %.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2017, kanë udhëtuar me linjë detare 1.431.999 pasagjerë, duke u rritur me 18,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Eksporti/Importi i mallrave sipas mënyrës së transportit


Në Nëntor 2017, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 80 mld lekë dhe 52,7 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Nëntor 2017, mallrat e eksportuara me det zënë 62,2 %, me rrugë 36,3 % dhe me ajër 0,5 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në Nëntor 2017, janë rritur me 26,8 % ndërsa me det janë rritur 40,0 %, krahasuar me Nëntor 2016.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2017



Gjatë njëmbëdhjetëmujorit 2017, mallrat e eksportuara me det zënë 62,8 %, me rrugë 35,9 % dhe me ajër 0,5 %.


Mallrat e eksportuara me rrugë, në njëmbëdhjetëmujorin 2017, u rritën 26,0 % ndërsa me det u rritën 8,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Importet e mallrave

Në Nëntor 2017, mallrat e importuara me det zënë 48,2 %, me rrugë 44,2 % dhe me ajër 2,5 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në Nëntor 2017, janë rritur me 5 herë dhe me det janë rritur me 6,0 %, krahasuar me Nëntor 2016.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2017




Gjatë njëmbëdhjetëmujorit 2017, mallrat e importuara me det zënë 48,9 %, me rrugë 44,0 % dhe me ajër 2,8 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në njëmbëdhjetëmujorin 2017, janë rritur 102,2 % dhe me rrugë janë rritur me 13,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Mallrat kryesore të eksportuara sipas mënyrës së transportit

Pesë grup-mallra kryesore, sipas Nomenklaturës së Transportit (NST 2007), kanë kontribuar me 73,9 %, në vlerën e mallrave të eksportuara në muajin Nëntor 2017.


Fig. 3 Grup-mallrat kryesore të eksportuara sipas mënyrës së transportit



Mallrat kryesore të importuara sipas mënyrës së transportit

Pesë grup-mallrat kryesore, sipas Nomenklaturës së Transportit (NST 2007), kanë kontribuar me 69,2 % të vlerës së mallrave importuar gjithsej në muajin Nëntor 2017.

Fig. 4 Grup-mallrat kryesore të importuara sipas mënyrës së transportit



Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti, Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar,

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë,

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det,

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër,

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv,

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues,

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi, Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor,

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë